

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI PEMËTARI –VRESHTARI
PROGRAMI PEMËTARI -VRESHTARI



PUNIM DIPLOME MASTER

Tema:

”NDIKIMI I MASAVE POMOTEKNIKE NE RENDIMENTIN DHE
CILËSINË E DISA KULTIVARËVE TË MJEDRËS”

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Mentor Thaqi

Kandidatja:

Bsc. Blenda Potera

Prishtinë, 2023

Abstrakti

Mjedra e kuqe (*Rubus idaeus* L.) i përket familjes Rosaceae dhe është gjerësisht kultivuar në Botë dhe në Kosovë, pasi ka rezistencë të shkëlqyer ndaj të ftohtit dhe rezistencë ndaj sëmundjeve. Frutat e mjedrës kanë nivele të larta të lëndëve ushqyese, veçanërisht sheqeri, acidet organike, vitaminat dhe komponimet fitokimike. Është e nevojshme të realizohen kërkime të vazhdueshme mbi përshtatshmërinë e kultivarëve të veçantë për kultivim në kushte specifike dhe mbi ndikimin e faktorëve të ndryshëm dhe teknologjive të prodhimit në rendimentin dhe cilësinë e mjedrës.

Punimi ka për qëllim të vlerësojë rendimentin dhe cilësinë e tre kultivarëve të mjedrës me teknologji të ndryshme prodhimi, në kushte të ndryshme pomoteknike në tre pemishte në komunën e Podujevës, përkatësisht në Podujevë - qytet në sipërfaqe 1.08 ha, në fshatin Letanc në sipërfaqe 0.5 ha dhe në fshatin Ballofc në sipërfaqe 1.20 ha. Në lokalitetin Ballofc bimët janë mbjellë me dendur, në distanca 2.8 m nëmes rendeve dhe 35 cm në rend, me 10,200 bimë për një hektar. Në Letanc distancat janë 2.8 m nëmes rendeve me 40 cm në rend, me 8,928 bimë në hektar. Në Podujevë, bimët janë mbjellë në distancë 3.0 m nëmes rendeve dhe 40 cm në rend, përkatësisht 8,333 bimë për një hektar. Në këto tre pemishte janë hulumtuar kultivarët Polka, Mapema, dhe Delniwa. Në laboratorin e Pemëtarisë në FBV janë bërë matjet e parametrave të frutave, si gjatësia, gjerësia, pesha e frutave, si dhe niveli i sheqernave të përgjithshëm në frut – Brix.

Nga rezultatet e fituara, bimët e kultivarit Mapema kanë kurorë më të zhvilluar me lartësi mesatare të kurorës në tre lokalitetet prej 155.7 cm, Delniwa ka 127.3 cm, ndërsa Polka 116.0 cm. Kultivari Mapema ka gjatësi të gjethit më të madhe me një mesatare 123.3 mm, Delniwa ka 113.3 mm dhe Polka 98.3 mm. Gjerësia e gjethit është e njëjtë te kultivarët Mapema dhe Delniwa prej 90 mm, ndërsa më e vogël te kultivari Polka prej 78.3 mm. Vjelja në tre lokalitetet është realizuar me dorë në çdo dy ditë. Në lokalitetin Ballofc janë realizuar 35 vjelje gjatë sezonit, në Letanc 36 vjelje, ndërsa në Podujevë – qytet 38 vjelje. Rendimenti më i lartë, për të tre kultivarët, është arritur në lokalitetin Podujevë – qytet, me mesatare prej 10,800 kg/ha për të tre kultivarët, pastaj në Letanc 8,900 kg/ha, e më i vogël në Ballofc 7,250 kg/ha. Në të tre lokalitetet, kultivari Delniwa ka arritur rendimentin më të lartë 9,283 kg/ha, ndërsa kultivari Mapema dhe Polka kanë arritur rendimente të ngjashme, 8,867 kg/ha përkatësisht 8,800 kg/ha.

Nga këto rezultate mund të konstatojmë se zbatimi i masave të duhura agroteknike dhe pomoteknike mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në rendimentin dhe cilësinë e mjedrës. Zgjedhja e kultivarit të duhur është një faktor i rëndësishëm në maksimizimin e rendimentit dhe prodhimin e mjedrave me cilësi të lartë. Kultivarët e rinj të mjedrës shpesh kanë tipare të përmirësuara si rezistenca ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve, rendiment më i lartë, frutat e mëdha, shije më të mirë dhe ruajtje më e gjatë pas vjeljes. Ato gjithashtu mund të zhvillohen për t'u pjekur më herët ose më vonë gjatë sezonit, gjë që mund të ndihmojë në zgjatjen e periudhës së vjeljes, dhe t'i përshtaten kushteve specifike të rritjes dhe kërkesave të tregut.

Fjalët kyçe: masat pomoteknike, kultivarët Polka, Mapema dhe Delniwa, rendimenti, cilësia e frutave.